



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Mbi miratimin e listës Nr.9 të familjeve të pastreha që do të trajtohen me kredi me interes 3%”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”, neni 16, 47 të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, VKM nr.453, datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar me VKM nr.268 datë 29.04.2022,

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Berat në bashkepunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit vazhdon zbatimin e projektit “Banesë me kosto të ulët, subvencionim të interesave të kredise”.

Ministria ka bërë përzgjedhjen e bankave që do të menaxhojnë këtë projekt nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë nga buxheti i shtetit dhe konkretisht: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa Sanpaolo.

Programi i subvencionimit të interesave të kredisë trajton familje /individë që kanë aplikuar në portalin e –albania “Kërkesë për t’u trajtuar me programin e strehimit social banesë me kosto të ulët, Subvencionim i interesave të kredise së zbutur”.

Përparësi në përzgjedhje për t’u trajtuar me këtë projekt kanë familjet që plotësojnë kriteret e përcaktuar në ligjin 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar të cilat janë:

Kushtet e strehimit ku përparësi kanë familjet që:

- nuk disponojnë banesë në pronësi;
- banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;
- banojnë në banesa të mbipopulluara;

Kushtet familjare ku përparësi kanë familjet që:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë;
- të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit;
- familjet me më shumë se katër fëmijë ;
- çiftet e reja .

Kushtet sociale ku përparësi kanë familjet që:

- personat me aftësi të kufizuar ;
- vajzat nëna ;
- anëtar të komunitetit rom e egjiptian;
- individë me status të jetimit etj

Kushtet ekonomike janë në përputhje me madhësinë e përbërjes familjare të përcaktuara nga INSTAT .

Situata financiare : Bashkia Berat për ta bërë procesin sa më transparentë në mënyrë që të mos penalizohet asnjë familje e interesuar dhe që plotëson kushtet e nivelit të të ardhurave mujore në fillim të procesit ka bërë njoftim në faqen zyrtare të bashkisë ëëë.bashkiaberat.gov.al më datë 30.09.2025 "*Mbi fillimin e projektit të subvencionimit të interesave të kredise*", ku janë publikuar dokumentacioni përkatës dhe kriteret që duhet të plotësojë çdo person i interesuar i cili ka aplikuar si i pastrehë në portalin e-albania.

Komisioni i Strehimit i mbledhur më datë 25.11.2025, ka miratuar subvencionimin e kredise për 8(tetë) familje të pastreha që do të trajtohen me kredi me interes 3%, të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe dokumentacionin përkatës, sipas tabelës bashkelidhur.

Ndërsa 10 familje u s'kualifikuan për mungesë dokumentacioni dhe për mos plotësim të kriterëve kualifikuese .

Drejtoria / Sektori përgjegjës

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE , PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

Impakti social / grupet që preken:

Grupet që preken janë familjet e pastreha me të ardhura të pamjaftueshme për të blerë një banesë.

A është objekt i konsultimit publik:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ky material nuk detyron zhvillimin e dëgjësive publike

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**”, i mbledhur në datën 04/12/2025, shqyrtoi projekt vendimin "Mbi miratimin e listës nr.9 të familjeve të pastreha që do të trajtohen me kredi me interes 3%"relacionin e dokumentat shoqërues propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile , Pronave, Transportit dhe Shërbimeve

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

- a. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
- b. Miratimin e listës emërore nr.9, të përbërë prej 8 (tetë) familjeve të pastreha që do të trajtohen me kredi me interes 3%,

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 04 /12/2025